



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly
Grupi i Deputetëve të Rinj - Grupa mladih poslanica - Youth Caucus

Rinia në Projektbuxhetin e Kosovës për vitin 2021

Nëntor, 2020

Përmbajtja

Të gjeturat kryesore	3
1. Baza ligjore dhe politikat mbi rininë	4
2. Gjendja e rinisë në Kosovë.....	5
3. Rinia dhe Projektbuxheti i Kosovës për vitin 2021	7
3.1. Programi për rini në kuadër të MKRS	7
3.2. Buxheti për rini në kuadër të komunave	10
3.3. Aftësimi profesional i të rinjve.....	11
3.4. Agjencia e Punësimit	11
4. Përfundime dhe rekomandime.....	13
Aneks: Aktivitetet për zbatimin e objektivave strategjike dhe buxheti për 2021.....	14

Të gjeturat kryesore

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 parasheh që deri në vitin 2021 përqindja e të rinjve të papunë, pa arsim dhe pa trajnim të bie nga 31.4% në 25%; dhe shkalla e papunësisë tek të rinjtë të bie nga 57.7% në 30% deri në vitin 2021. Në fund të vitit 2019 shkalla e papunësisë tek të rinjtë është 49.4%. Kurse shkalla e të rinjve të papunë, pa arsim e pa shkollim (NEET) është 32.7%, më e larta e regjistruar që nga viti 2012.
- 70% e të rinjve dëshirojnë të punojnë në sektorin publik e vetëm 23% në sektorin privat;
- Vetëm 10% e të rinjve mendojnë se se interesat e tyre janë të përfaqësuara në politikat nacionale;
- 57% e të rinjve do të largoheshin nga Kosova nëse u jepet një mundësi e tillë, 41% e atyre që dëshirojnë të emigrojnë nuk kanë aspak njohuri të gjuhës në vendin ku dëshirojnë të emigrojnë;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) ka hartuar Strategjinë për Rininë 2019-2023, për zbatimin e së cilës nevojiten 11.6 milionë euro për katër vite, kurse për vitin 2021 nevojiten 2.5 milionë euro;
- Buxheti për departamentin e rinisë në kuadër të MKRS për vitin 2021 do të jetë 2.2 milionë euro apo 6.33% e buxhetit total të MKRS për vitin 2021;
- Pëkundër asaj se buxheti i MKRS për vitin 2021 do të pësoj rënie, buxheti për rini shënon një rritje të vogël krahasim me 2020 (3.6%);
- Buxheti total për rini më 2021 do të jetë më i vogël se sa buxheti i nevojshëm për zbatimin e aktiviteteve që dalin nga Strategjia për Rininë për vitin 2021;
- Me strategji parashihet edhe një fond i veçantë për mobilitetin rinor në shumën prej 450,000 euro, mirëpo ky fund asnjëherë nuk është vendosë si linjë e veçantë buxhetore në MKRS;
- Vetëm 4 nga 38 komuna kanë linja të veçanta buxhetore për rininë. Andaj është e pamundur të dihet se sa nga buxheti total i komunave për kulturë, rini dhe sport ndahet vetëm për rini. Komunitat që bëjnë ndarjen specifike të buxhetit për rini, nga buxheti total për kulturë, rini dhe sport për rini ndajnë mes 4.6% dhe 26%, apo mesatarisht 13.6% të buxhetit;
- Në total të gjitha komunat kanë ndarë 19,432,377 euro për kulturë, rini dhe sport. Pjesa më e madhe do të shkojë për investime kapitale (42%), paga dhe meditare (22%), subvencione dhe transfere (18%);
- Aftësimi profesional i të rinjve është një ndër objektivat strategjike me Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021. Me Projektbuxhetin e vitit 2021 buxheti për programet e aftësimit profesional është rritur dhe është shtuar një linjë e re buxhetore për arsimin profesional;
- Përderisa buxheti për shërbimet e punësimit është rritur në tri vitet e fundit, buxheti për shërbimet e aftësimit profesional është në rënie që nga viti 2011.

1. Baza ligjore dhe politikat mbi rininë

Në vitin 2009 ka hyrë në fuqi **Ligji nr.03/L-145 për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë**¹ i cili ka për qëllim avancimin dhe riafirmimin e vazhdueshëm të pjesëmarrjes së të rinjve në procesin e vendimmarrjes. Sipas Ligjit, moshë rinore konsiderohet grupmosha e të rinjve prej 15 deri 24 vjeç.

Sipas Ligjit, organet e pushtetit qendror janë përgjegjëse për zhvillimin, miratimin dhe zbatimin e dokumenteve përkatëse të sektorit të rinisë; zhvillimin e procedurave dhe kriterëve për avancimin dhe njohjen e punës vullnetare dhe të formave të tjera të veprimtarive të rinisë; për mbledhjen dhe ofrimin e të dhënave për pozitën e të rinjve; mbështetjen e programeve për zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve në sektorin e rinisë. Kurse, organet e pushtetit komunal kanë përgjegjësi për tu kujdesur për sigurimin e resurseve njerëzore dhe financiare për realizimin e programeve të rinisë; sigurimin e hapësirave ku të rinjtë zhvillojnë aktivitetet e tyre dhe edukimin joformal; zhvillimin e politikave rinore lokale.

Në secilën komunë formohet këshilli i veprimit rinor lokal si formacion këshillues i organizatave rinore që veprojnë në nivelin lokal dhe përfaqësojnë interesat e organizatave rinore dhe të rinjve tek institucionet e pushtetit lokal. Këshilli Qendror i Veprimit Rinor është organizim vullnetar i organizatave rinore që veprojnë në Kosovë. Komunat licencojnë qendrat rinore të cila ofrojnë hapësirë për programet dhe veprimtaritë e të rinjve.

Bazuar në këtë ligj, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) ka aprovuar **Strategjinë për Rininë 2019-2023**². Strategjia vendos tri objektiva strategjike:

1. Mobilizimi i rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive;
2. Ofrimi i shkathtësive dhe përgatitja e të rinjve për tregun e punës, dhe
3. Mjedis i shëndetshëm dhe i sigurtë për të rinjtë.

Për zbatimin e Strategjisë për pesë vite nevojiten 11,661,900 euro, prej të cilave 2,491,500 në vitin 2021.

Tab.1: Buxheti i nevojshëm për zbatimin e Strategjisë së Rinisë 2019-2023

Objektivi strategjik	Buxheti					
	2019	2020	2021	2022	2023	Total
Mobilizimi i rinisë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive	938,500	1,275,000	1,266,500	1,266,500	1,266,500	6,013,000
Ofrimi i shkathtësive dhe përgatitja e të rinjve për tregun e punës	334,500	635,000	665,000	695,000	725,000	3,054,500
Mjedis i shëndetshëm dhe i sigurtë për të rinjtë	319,400	555,000	560,000	580,000	580,000	2,594,400
Total	1,592,400	2,465,000	2,491,500	2,541,500	2,571,500	11,661,900

Në korrik të vitit 2016 Qeveria ka aprovuar edhe **Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021**³, i cili vendos shtatë objektiva strategjike: 1.Pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja, 2.Menaxhimi i sistemit arsimor, 3.Sigurimi i cilësisë, 4.Zhvillimi i mësimdhënësve, 5.Mësimdhënia dhe të nxënit,

¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.03/L-145 për fuqizimin dhe pjesëmarrjen e rinisë. 2009. Burimi: <https://bit.ly/2JbCPD8>

² Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Strategjia e Rinisë 2019-2023. Qershor, 2019. Burimi: <https://bit.ly/2J3J8ZY>

³ Zyra e Kryeministrit. Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021. Korrik 2016. Burimi: <https://bit.ly/2V4WvLS>

6.Arsimi dhe aftësimi profesional dhe arsimi i të rriturve, 7.Arsimi i lartë. Për zbatimin e Planit nevojiten 176.9 milionë euro, 40 milionë prej të cilave në vitin 2021.

Tab.2: Buxheti i nevojshëm për zbatimin e Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021

Fusha prioritare	Shpenzime totale					
	2017	2018	2019	2020	2021	Gjithsejtë
Pjesëmarrja dhe përfshirja	442,243	565,705	571,950	561,890	550,140	2,691,927
Menaxhimi i sistemit arsimore	15,129,350	22,520,540	22,052,225	19,664,695	18,663,950	98,030,760
Sigurimi i cilësisë	605,646	526,698	458,640	328,400	314,400	2,233,784
Zhvillimi i mësimdhënësve	1,057,900	1,989,950	2,896,900	3,822,500	4,783,500	14,550,750
Mësimdhënia dhe të nxënit	2,970,990	6,240,790	6,614,840	6,961,690	7,640,560	30,428,870
Arsimi profesional	1,699,959	1,567,035	1,238,225	1,143,707	1,124,020	6,772,946
Arsimi i lartë	2,647,960	3,478,880	3,648,980	5,099,120	7,357,560	22,232,500
Total	24,554,048	36,889,598	37,481,760	37,582,002	40,434,130	176,941,537

Me **Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2016-2021 (SKZH)** parashihet që me qëllim të përmbushjes së obektivit strategjik për Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor të merren edhe masa që kanë të bëjnë me ndërlidhjen më të mirë ndërmjet sistemit arsimore dhe tregut të punës dhe adresimin e sfidave të punësimit jo formal dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për punë.⁴

2. Gjendja e rinisë në Kosovë

Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, ku 20% e popullsisë bën pjesë në grupmoshën 15 deri 24 vjeç.⁵ Rreth 78 mijë të rinjë nga të gjitha grupet etnike në Kosovë janë studentë. Por vetëm 23% e të rinjve janë të kënaqur me kualitetin e edukimit në Kosovë. Kjo është shkalla më e ulët e kënaqshmërisë në krahasim me vendet tjera të rajonit.⁶

Tab.3: Të rinjtë studentë sipas etnive

	Shqiptarë		Serb		Turq		Boshnjak		Goran		Ashkali		Rom		Egjiptian		Tjerë	
	Publik	Privat	Publik	Privat	Publik	Privat	Publik	Privat	Publik	Privat	Publik	Privat	Publik	Privat	Publik	Privat	Publik	Privat
2015/16	81,794	2,420	166	-	727	21	824	6	3	8	190	2	131	2	70	-	1	11
2016/17	84,268	2,876	159	5	677	21	881	10	2	1	236	-	151	2	72	-	1	30
2017/18	84,693	2,837	156	-	485	31	915	6	10	4	255	-	156	-	142	-	1	23
2018/19	78,753	3,139	160	-	642	21	882	-	7	8	261	-	161	-	160	-	15	39
2019/20	72,247	3,427	156	-	594	22	843	4	9	2	259	-	182	-	137	-	-	24

Burimi: Instituti GAP, bazuar në të dhënat e ASK

Si alternativë, të rinjtë mund të vazhdojnë edhe Arsimin dhe Aftësimin Profesional (AAP).

⁴ Zyra e Kryeministrit. Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021. Burimi: <https://bit.ly/33jOIDI>

⁵ Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Strategjia e Rinisë 2019-2023. Qershor, 2019. Burimi: <https://bit.ly/2J3J8ZY>

⁶ Friedrich Ebert Stiftung. Youth Study Kosovo 2018/2019. Burimi: <https://bit.ly/2V20KYv>

Tab.4: Ndjekësit e Arsimit dhe Aftësimi Profesional

	2014/15		2015/16		2016/17		2017/18		2018/19	
	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza	Djem	Vajza
Arte dhe shkenca humane	434	517	466	677	491	832	534	1,024	425	1,023
Biznes, administrate dhe juriidk	7,674	6,181	7,481	6,146	7,204	6,346	7,208	6,609	6,619	5,762
TIK	3,617	1,643	3,500	1,604	3,731	1,729	3,697	1,602	3,384	1,388
Inxhinieri, prodhimtari&ndertimtari	10,443	3,071	10,603	3,151	11,747	3,595	11,710	3,578	11,143	3,391
Bujqesi, pylltari, peshkatari&veteri	1,039	434	1,167	549	897	404	1,168	656	1,005	536
Shendetesi dhe mireqenie	1,873	4,212	2,064	4,400	2,330	4,822	2,430	5,161	2,527	5,495
Sherbime	837	220	865	300	895	363	968	338	768	319
Tjera	246	120	17	20	-	-	59	24	16	2

Burimi: KEEN, Punësimi dhe Aftësimi Profesional në Kosovë

Papunësia tek të rinjtë mbetet ende e lartë edhe pse viteve të fundit ka një rënie. Në vitin 2019 shkalla e papunësisë të të rinjve ishte 49.4%, në kararasim me numrin e përgjithshëm të papunësisë prej 25.7%.⁷ Shkalla e papunësisë tek vajzat është më e lartë (60.3%) se sa tek djemtë (44.1%). Shqetësuese mbetet shkalla e lartë e të rinjve që nuk janë të punësuar, as në shkollim, as në trajnim (NEET) e cilë në vitin 2019 është 32.7%, më e larta e regjistruar që nga viti 2012.

Tab.5: Buxheti i nevojshëm për zbatimin e Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021

	Indicator	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Fuqi punëtore	Fuqia punëtore (15-19 vjeç, në mijëra)	15.5	12.7	16.7	15.0	13.1	20.8
	Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (15-19 vjeç)	8.3%	7.4%	9.2%	8.2%	7.5%	12.1%
	Fuqia punëtore (20-24 vjeç, në mijëra)	67.2	56.5	56.5	66.9	62.6	67.2
	Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (20-24 vjeç)	38.9%	33.2%	34.5%	40.9%	38.6%	40.0%
Punësimi	Punësimi (15 - 24 vjeç, në mijëra)	32.2	29.3	34.9	38.7	33.8	44.5
	Punësimi në relacion me grupmoshen (15 – 24 vjeç)	9.0%	8.5%	10.1%	11.2%	10.0%	13.1%
Papunësia	Papunësia (15 - 24 vjeç, në mijëra)	50.4	39.9	38.3	43.2	42.0	43.4
	Shkalla e papunësisë (15 - 24 vjeç, in %)	61.0%	57.7%	52.4%	52.7%	55.4%	49.4%
	Të rinjtë NEET (15 - 24 vjeç, në mijëra)	108.2	107.6	103.8	94.8	101.6	111.1
	% e të rinjve NEET në krahasim në popullsinë e të rinjve	30.2%	31.4%	30.1%	27.4%	30.1%	32.7%

Burimi: Instituti GAP, bazuar në të dhënat e ASK⁸

Shumica e të rinjve (81%) ende jetojnë ende me prindërit. Vetëm 28% e të rinjve kanë kryer ndonjë punë praktike dhe 54% e të rinjve besojnë se sigurimi i një vendi të punës është i mundshëm vetëm nëse ekzistojnë lidhje politike ose familjare me njerëzit në pushtet. Një shkallë shumë e lartë e të rinjve (70%) do të dëshironin që të punojnë në sektorin publik dhe vetëm 23% në sektorin privat. Vetëm 10% e të rinjve mendojnë se interesat e tyre janë të përfaqësuara në politikat nacionale. Nëse do ju jepej mundësia, 57% e të rinjve do të largoheshin nga Kosova për të gjetur punë në vendet e Bashkimit Evropian, ani pse 41% e atyre që dëshirojnë të emigrojnë nuk kanë aspak

⁷ ASK. Anketa e Fuqisë Punëtore 2019. Burimi: <https://bit.ly/3o1HAOC>

⁸ Instituti GAP. Descriptive Analysis of Youth Labour and Education Statistics. Korrik 2020. Burimi: <https://bit.ly/364ISCY>

njohuri të gjuhës në vendin ku dëshirojnë të emigrojnë. 61% e të rinjve nuk planifikon që të vazhdoj studimet jashtë Kosovës.⁹


3. Rinia dhe Projektbuxheti i Kosovës për vitin 2021

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) është institucioni përgjegjës qendror për rininë dhe drejtoritë e kulturës, rinisë dhe sportit janë përgjegjëse për rininë në nivel komunal. Mirëpo, edhe ministratë tjera, sidomos Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) luajnë rol në edukimin dhe fuqizimin e rinisë.

3.1. Programi për rini në kuadër të MKRS

Buxheti për MKRS me Projektbuxhetin 2021 është më i ulët se sa buxheti i rishikuar 2020 për 3.6 milionë euro apo një rënie prej 9.4%. Rënia më e madhe ka ndodhur në kategorinë e shpenzimeve kapitale (4.1 milionë euro apo 18.8% rënie).


Graf.1: Buxheti i MKRS 2014-2021 sipas kategorive të shpenzimeve



Përkundër rënies, edhe më tej shpenzimet kapitale janë kategoria kryesore e shpenzimeve në MKRS (52%), pastaj vijnë subvencionet dhe transferet (28%), paga dhe medijtje (14%).


⁹ Friedrich Ebert Stiftung. Youth Study Kosovo 2018/2019. Burimi: <https://bit.ly/2V20KYv>

Graf.2: Peshë e buxhetit sipas kategorive kryesore buxhetore në MKRS 2014-2021




Nga buxheti total i MKRS-së prej 34.9 milionë euro, 2.2 milionë euro ndahen për programin e rinisë, apo 6.33% e buxhetit total. Edhe pse ka rënie të buxhetit total të MKRS më 2021 në krahasim me buxhetin e rishikuar të 2020, **buxheti për rini është rritur për 81,413 euro apo 3.6%**.

Graf.3: Buxheti për programin e rinisë në kuadër të MKRS, 2017-2021




Në kuadër të programit për rini, funksionojnë tri nënprograme: 1.Mbrojtja dhe integrimi i rinisë; 2.Zhvillimi dhe përkrahja e rinisë; zhvillimi i politikave integruese. Pjesa më e madhe e buxhetit ndahet për nën-programin ‘zhvillimi dhe përkrahja e rinisë’.

Graf.4: Buxheti për programin e rinisë në kuadër të MKRS, 2017-2021



Sa i përket kategorive buxhetore, prej buxhetit total për rini, 78% shkon për subvencione dhe transfere, 15% për shpenzime kapitale dhe 7% për paga dhe meditje.

Graf.5: Buxheti i MKRS në Programin e Rinisë sipas kategorive të shpenzimeve



Buxheti prej 330,000 euro për shpenzime kapitale për vitin 2021 është i gjithi i bartur nga viti 2020.

Tab.6: Investimet kapitale të MKRS për rini 2021

Zhvillimi dhe Përkrahja e Rinisë	Shpenzime deri më 2020	Vazhdim nga viti 2020	2021	2022	2023	Total
Qendra Rinore ne Prizren	0	0	0	50,000	0	50,000
Qendra Rinore në Podujevë	995	50,000	50,000	70,000		170,995
Qendra Rinore në Kllokot	0	25,000	25,000	50,000	25,000	125,000
Qendra Rinore ne Junik	0	50,000	50,000	50,000	50,000	200,000
Qendra Rekreative Rinore në Pjetershan, Gjakovë	108,838	55,000	55,000	0	0	218,838
Qendra Rinore në Deçan	0	50,000	50,000	50,000	25,000	175,000
Qendra Rinore në Fushë Kosovë	0	50,000	50,000	50,000	50,000	200,000
Qendra multifunkionale në Ferizaj	0	50,000	50,000	25,000	0	75,000

Buxheti i MKRS për programin për rini për vitin 2021 është më i vogël se sa buxheti që nevojitet për zbatimin e veprimeve dhe mbërritjen e objektivave strategjike me Strategjinë për Rini. Për vitin 2021 Strategjia kërkon afër 2.4 milionë euro.

Me strategji parashihet edhe një fond i veçantë për mobilitetin rinor në shumën prej 450,000 euro, mirëpo ky fund asnjëherë nuk është vendosë si linjë e veçantë buxhetore në MKRS.


3.2. Buxheti për rini në kuadër të komunave

Vetëm 4 nga 38 komuna kanë linja të veçanta buxhetore për përkrahjen e rinisë (Ferizaj, Malisheva, Gjakova, Parteshi). Të gjitha komunat tjera nuk bëjnë ndarje mes buxhetit për kulturë, rini dhe sport. Andaj është e pamundur të dihet se sa nga buxheti total i komunave për kulturë, rini dhe sport ndahet vetëm për rini.

Katër komunat që bëjnë ndarjen specifike të buxhetit për rini, nga buxheti total për kulturë, rini dhe sport ndajnë për rini mes 4.6% (Gjakova) deri 26% (Parteshi), apo mesatarisht 13.6% të buxhetit.

Në total të gjitha komunat kanë ndarë 19,432,377 euro për kulturë, rini dhe sport. Pjesa më e madhe do të shkojë për investime kapitale (42%), paga dhe meditare (22%), subvencione dhe transfere (18%).

Graf.5: Buxheti i MKRS në Programin e Rinisë sipas kategorive të shpenzimeve



3.3. Aftësimi profesional i të rinjve

Aftësimi profesional i të rinjve është një ndër objektivat strategjike me Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017-2021. Me Projektbuxhetin e vitit 2021 buxheti për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është rritur. Njësoj është rritur edhe buxheti për programet e aftësimit profesional. Me Projektbuxhetin 2021 është shtuar një linjë e re buxhetore për arsimin profesional.

Tab.7: Buxheti i MASHT dhe programeve të aftësimit profesional, 2017-2021

	2017	2018	2019	2020	2021
Buxheti total i MASHT	47,287,848	58,003,626	73,238,320	63,016,677	64,116,454
Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve	243,785	228,785	265,899	215,012	315,899
Arsimi profesional	-	-	-	-	347,003
Agjencia Arsimit dhe Aftësimit Profesional	3,161,865	3,454,865	3,672,222	3,808,738	3,966,468
Aftësimi profesional si % e buxhetit total të MASHT	7.20%	6.30%	5.30%	6.30%	7.20%

3.4. Agjencia e Punësimit

Me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2016-2021 (SKZH) parashihet që me qëllim të përmbushjes së obkektivit strategjik për Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor të merren edhe masa që kanë të bëjnë me ndërlikdhjen më të mirë ndërmjet sistemit arsimor dhe tregut të punës (masa 3) dhe adresimin e sfidave të punësimit jo formal dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për punë (masa 7).¹⁰

Me udhërrëfyesin për zbatimin e SKZH parashihej që deri në vitin 2021 përqindja e të rinjve të papunë, pa arsim dhe pa trajnim të bie nga 31.4% në 25%; dhe shkalla e papunësisë tek të rinjë të

¹⁰ Zyra e Kryeministrit. Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021. Burimi: <https://bit.ly/33jOIDI>

bie 57.7% në 30% deri në vitin 2021.¹¹ Në fund të vitit 2019 shkalla e papunësisë tek të rinjtë është 49.4%. Kurse shkalla e të rinjve të papunë, pa arsim e pa shkollim (NEET) është 32.7%, më e larta e regjistruar që nga viti 2012.


Nga janari i vitit 2015 është në fuqi Ligji për Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës. Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK) është organ i pavarur në kuadër të MPMS. Departamenti për Punë dhe Punësim i cili ka ekzistuar deri më 2015 në kuadër të MPMS, është bartur tek APRK.

Në kuadër të Agjencisë së Punësimit janë dy divizione kryesore: shërbimet e punësimit dhe shërbimet e aftësisimit profesional.

Në vitin 2018 (raporti i fundit), të rinjtë e moshës 15 deri 24 vjeç përbënin 19.5% të papunëve të regjistruar në kuadër të zyreve të punësimit, një rritje prej 3% në krahasim me vitin 2017.¹² Ndërsa sa i përket punësimeve të ndërmjetësuar nga APRK, të rinjtë e moshës 15 deri 24 vjeç përbëjnë 19.2% të të gjitha punësimeve të ndërmjetësuar, një rënie prej 1.9% në krahasim me 2017. Sa i përket aftësisimit profesional, të rinjtë përbëjnë 37% të të aftësuarve më 2018.

Përderisa buxheti për shërbimet e punësimit është rritur në tri vitet e fundit, buxheti për shërbimet e aftësisimit profesional është në rënie që nga viti 2011.

Graf.6: Buxheti i shërbimeve në kuadër të ARBK



¹¹ Agron Demi. Politikat e Punësimit dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë – raport vlerësimi. KEEN, 2019. Burimi: <https://bit.ly/3671Isz>

¹² APRK. Puna dhe Punësimi në Kosovë 2018. Burimi: <https://bit.ly/2J2Dt6s>

4. Përfundime dhe rekomandime

Një ndër problemet e vazhdueshme që përsëritet çdo vit është edhe mungesa e ndërlidhjes mes buxhetit shtetëror me politikat sektoriale. Edhe në rastin e rinisë, nuk ka një ndërlidhje të qartë në mes të obligimeve buxhetore që dalin nga Strategjia për Rini 2019-2023 dhe Projektbuxhetit të Kosovës për vitin 2021. Buxheti për departamentin për rini më 2021 është më i vogël se sa kostoja e veprimave që dalin nga Strategjia për Rini për vitin 2021.

Po ashtu, targetet e vendosura me Udhërrëfuesin për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 nuk duket se do të arrihen, sidomos ulja e papunësisë së të rinjve dhe ulja e të rinjve NEET tek të rinjtë e papunë.

Me qëllim të zbatimit të politikave për fuqizimin e rinisë, Projektbuxheti i Kosovës për vitin 2021 duhet që:

- Programi për Rini në kuadër të MKRS dhe departamentet komunale për kulturë, rini dhe sport të kenë një lidhje të qartë me aktivitetet e parapara me Strategjinë për Rini 2019-2023.
- Fondi për mobilitet rinor prej 450.000 euro, i paraparë me Startegjinë për Rini, të përfshihet si fond i veçantë në Projektbuxhetin për vitin 2021.
- Në linjat buxhetore të komunave për kulturë, rini dhe sport, të ketë një ndarje të qartë se sa nga buxheti total do të ndahet për rininë.
- Institucionet publike të bëjnë më shumë që në vitin 2021 të arrihen objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim për uljen e papunësisë së të rinjve në 30% dhe rënien e përqindjes së të rinjve të papunë, pa arsim dhe pa trajnim (NEET) në 25%. Të dhënat e fundit për vitin 2019 nuk japin shpresë se këto objektiva do të arrihen deri në fund të vitit 2021.
- Me qëllim të rritjes së objektivave për uljen e përqindjes së NEET, nevojitet rritja e buxhetit për shërbimet e aftësimin profesional në kuadër të Agjencisë së Punësimit në Republikën e Kosovës. Buxheti i projektuar për vitin 2021 për shërbimet e aftësimin profesional është më i ulët se në vitin 2012.

Aneks: Aktivitetet për zbatimin e objektivave strategjike dhe buxheti për 2021

Objektivat dhe aktivitetet për zbatimin e Strategjisë së Rinisë 2019-2023		Buxheti 2021
1	Rini e mobilizuar për pjesëmarrje, përfaqësim dhe qytetari aktive	
1.1	Konsolidimi, funksionalizimi dhe fuqizimi i Organizatave Rinore	
1.1.1	Ngritja e kapaciteteve për Organizatat Rinore lidhur me zhvillimin organizativ	12,000
1.1.2	Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve rinorë komunalë	16,000
1.1.3	Përkrahja e nismave që mundësojnë krijimin e rrjeteve formale dhe joformale (ndarja e mjeteve financiare, deri në 10 mijë euro në vit - jo më shumë se 3 rrjete në vit)	10,500
1.1.4	Mbështetja e projekteve ose nismave për aktivizmin rinor në komunitet / mobilitetin rinor	150,000
1.1.5	Përkrahja e Organizatave Rinore përmes sigurimit të kontributit/pjesëmarrjes gjatë aplikimit në fondet e agjencive zhvillimore dhe programeve të tyre	100,000
1.1.6	Përkrahja e Organizatave Rinore që promovojnë, ndërgjegjësojnë për të drejtat dhe përgjegjësitë e të rinjve	100,000
1.2	Konsolidimi i legjislacionit për rininë	
1.2.1	Promovimi i mekanizmave ligjorë për rritjen e pjesëmarrjes në vendimmarrje	4,000
1.2.2	Realizimi i hulumtimeve lidhur me gjendjen e sektorit të rinisë dhe monitorimi i rregullt i zbatueshmërisë së legjislacionit lidhur me pjesëmarrjen	9,000
1.2.3	Krijimi i platformës digjitale për legjislacionin primar, sekondar, nismat ligjore, politikat rinore, strategjitë lokale dhe planet e veprimit në shërbim të të gjitha organizatave rinore	1,000
1.3	Përkrahja për mobilitetin rinor	
1.3.1	Ndërgjegjësimi i komunitetit rinor për pjesëmarrje dhe qytetari aktive	4,000
1.3.2	Ofrimi i mbështetjes për ndërtimin dhe rehabilitimin e qendrave rinore, përfshirë ndërtimin dhe rehabilitimin terreneve rekreative dhe sportive për zhvillim të aktiviteteve sociale të të rinjve	350,000
1.3.3	Inventarizimi, përditësimi dhe katalogizimi i shërbimeve të Organizatave Rinore që ofrohen për të rinjtë	-
1.3.4	Ndarja e fondit të veçantë për mobilitetin rinor	450,000
1.4	Zhvillimi i vullnetarizmit	
1.4.1	Promovimi i vullnetarizmit dhe i punës vullnetare	-
1.4.2	Menaxhimi i procesit të punës vullnetare	-
1.4.3	Njohje e punës vullnetare të të rinjve nga DiR të cilët rekomandohen nga organizatat rinore që ofrojnë punë vullnetare	-
1.4.4	Përkrahja e Organizatave Rinore që promovojnë vullnetarizmin dhe punën vullnetare	60,000
2	Rini e shkathtësuar dhe përgatitur për treg të punës	
2.1	Zhvillimi i edukimit jo formal	
2.1.1	Organizimi i ngjarjeve që çojnë drejt edukimit jo formal	150,000
2.1.2	Organizimi i ngjarjeve rinore për promovimin e edukimit jo formal	50,000
2.2	Ofrimi dhe promovimi i mundësive për kyçje në tregun e punës	
2.2.1	Promovimi dhe ndërgjegjësimi i rinisë për orientim në karrierë dhe treg adekuat të punës	8,000
2.2.2	Organizimi dhe përkrahja e panairëve për informimin e të rinjve mbi rëndësinë dhe nxitjen e tyre për kyçje në tregun e punës	40,000
2.2.3	Përcaktimi i prioritetëve dhe i deficiteve në tregun e punës përmes hulumtimeve të vazhdueshme	9,000
2.2.4	Hartimi i kriterëve dhe i standardeve për përkrahjen për ndërmarrësitë rinore, dhe i udhërrëfyeseve për ndërmarrësitë që kanë synim rininë	-
2.2.5	Themelimi i trupi koordinues për përkrahjen e ndërmarrësisë tek të rinjtë me përfshirje të gjerë të hisedarëve shtetërorë dhe agjencive zhvillimore	-
2.2.6	Përkrahja e Organizatave Rinore që merren me këshillim dhe orientim në karrierë, shkathtësim dhe ndërmjetësim të rinisë me tregun e punës	100,000

	2.2.7	Organizimi i ngjarjeve promovuese me komunitetin e biznesit dhe palët tjera të interesit për mundësitë e punësimit dhe të vetëpunësimit të të rinjve	8,000
	2.2.8	Përkrahja e nismave kreative për themelimin e bizneseve të reja të të rinjve	300,000
3	Mjedis i shëndetshëm dhe i sigurtë për të rinjtë		
	3.1	Promovimi i mënyrës së shëndetshme të jetesës dhe mirëqenjes së të rinjve	
	3.1.1	Organizimi i ngjarjeve ndërgjegjësuese për dukuritë negative që cenojnë shëndetin e rinisë	8,000
	3.1.2	Përkrahja e Organizatave Rinore që merren me promovimin e mjedisit të shëndetshëm	30,000
	3.1.3	Përkrahja e Organizatave Rinore që përmes fushatave, trajnimeve, punëtorive, debateve dhe aktiviteteve të tjera promovojnë mënyrën e shëndetshme të jetesës tek të rinjtë, duke përfshirë ushqimin e shëndetshëm, shëndetin mendor, parandalimin e dhunës psikike dhe fizike, përdorimin e substancave të dëmshme, marrjen me aktivitete fizike etj.	60,000
	3.1.4	Promovimi dhe ndërgjegjësimi i rinisë për dukuritë që cenojnë shëndetin	5,000
	3.2	Rritja e sigurisë së rinisë	
	3.2.1	Organizohen hulumtime të thella për dukuritë që cenojnë mjedisin e sigurtë dhe të shëndetshëm të rinisë	24,000
	3.2.2	Përkrahja e Organizatave Rinore që merren me ndërgjegjësimin për mjedisin e sigurtë	100,000
	3.2.3	Zhvillimi i kapaciteteve të personelit të institucioneve qendrore dhe lokale të sektoreve të rinisë për kanosjet dhe ruajtjen e mjedisit të sigurtë për të rinjtë	8,000
	3.2.4	Zhvillimi i kapaciteteve të personelit të Organizatave Rinore për kanosjet dhe ruajtjen e mjedisit të shëndetshëm dhe të sigurtë për të rinjtë	40,000
	3.2.5	Ndërgjegjësimi i rinisë për dukuritë negative shoqërore si trafikimi, ekstremizmi, kriminaliteti etj përfshirë parandalimin	10,000
	3.2.6	Organizimi i kampit tradicional rinor që promovon sigurinë si dhe promovimin e paqes për të gjithë etnitë	60,000
	3.2.7	Përkrahja e Organizatave Rinore lidhur me realizimin e intervenimit të hershëm në komunitet	80,000
	3.3	Integrimi i të rinjve në jetën shoqërore përmes aktiviteteve të ndryshme kulturore, sportive dhe rekreative	
	3.3.1	Integrimi shoqëror i të rinjve përmes kulturës, sportit dhe rekreacionit	40,000
	3.3.2	Organizimi i aktiviteteve tradicionale për të rinjtë.	25,000
	3.3.3	Përkrahja e të rinjve në iniciativa kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e sportit dhe kulturës	10,000
	3.3.4	Rritja e kohezionit social ndëretnik në mes të rinjve	20,000
	3.3.5	Mbështetja e femrave të reja dhe të rinjve në zonat rurale	40,000

Kjo analizë është përgatitur nga konsulenti i angazhuar nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI). Analiza buxhetore synon ta mbështes Grupin e Deputetëve të Rinj në shqyrtimin e projektbuxhetit 2021.

Publikimi i këtij dokumenti është mundësuar me mbështetjen e popullit zemërgjerë Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë qëndrimet e USAID dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

